

Fejton “Pavarësia dhe fati i minoriteteve (1991-1992)” (3)

Shmangia nga koncepti i minoritetit

Originaliteti i kornizës së Jugosllavisë socialiste ishte se askush në Jugosllavi nuk ishte minoritet, pa marrë parasysh madhësinë e popullatës apo të territorit. Koncepti i “minoritetit” e humbi kuptimin neutral dhe fitoi konotacione negative, e shpeshherë edhe fyese

Jugosllavia socialiste e ka trajtuar çështjen e minoriteteve në një mënyrë origjinale, por ajo kurrë tërësisht nuk ishte e suksesshme në përmbushjen e premtimit për largimin e nacionalizmit nga politika, gjë që ishte një pjesë e rëndësishme e sharmit të lëvizjes partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Komunistët në Jugosllavinë e Titos nuk e pranonin nocionin se shumicat dhe minoritetet mund të jenë faktorët vendosës në politikë. Regjimi komunist jugosllav nuk e njihte as konceptin e minoriteteve etnike dhe religjioze. Në vend të kësaj, vendi kishte gjashtë kombe të njohura jugosllave: serbët, kroatët, slovenët, maqedonasit, malazeztë dhe, prej vitit 1968, myslimanët (një kategori/komb etnik që tash e quan veten boshnjakë).

Këto gjashtë kombe në parim ishin të barabarta, kështu që serbët, që përbënin 35-40% të popullatës së vendit, konsideroheshin formalisht të barabartë me malazeztë që përbënin më pak se 3 për qind të popullatës së vendit. Të gjashtë kombet janë konsideruar si popuj konstitutivë - pra, popuj me republikat e tyre, edhe nëse ndodhte që një pjesë e popullit të jetojë jashtë republikës amë. Me përjashtime të

vogla, popujt e tjerë të numërt të Jugosllavisë janë klasifikuar si kombësi, edhe pse ata gëzonin të drejta specifike që në vende të tjera njiheshin si të drejta të minoriteteve (në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 fjala kombësi definohej si “pjesëtarë të kombeve, vendet amë të të cilave kufizohen me Jugosllavinë”). Originaliteti i kornizës së Jugosllavisë socialiste ishte se askush në Jugosllavi nuk ishte minoritet, pa marrë parasysh madhësinë e popullatës apo të territorit. Koncepti i “minoritetit” e humbi kuptimin neutral dhe fitoi konotacione negative, e shpeshherë edhe fyese.

Zhdukja publike e fjalës “minoritet”

Hartimi i kujdesshëm i fjalive në kushtetutën jugosllave dhe në ato të republikave dhe krahinave siguronte që kjo fjalë të zhduket nga përdorimi publik, edhe kur alternativat nuk mund ta zëvendësonin atë në mënyrë kuptimplote. Komunizmi jugosllav përshkruhej edhe si një projekt në të cilin elita nuk e përfaqësonte në rend të parë realitetin por një të ardhme të dëshiruar.

Lëvizja Komuniste e Jugosllavisë

e dënonte Jugosllavinë e kohës së para Luftës së Dytë Botërore për unitarizëm, centralizëm dhe burokratizëm, dhe hedhte poshtë parimet e qeverisë parlamentare në të cilat shteti ishte themeluar. Në vend të kësaj, komunistët ofronin një sistem të decentralizuar të vetëqeverisjes së punëtorëve që u jepte dinjitet të gjithë popujve, edhe kombeve e kombësive, nën flamurin e gjerë të socializmit.

Tito besonte që grupet etnike mund të krenohen me identitetin e tyre dhe të kultivojnë kulturën e tyre në mënyrë më të efektshme në sistemin socialist jugosllav sesa në demokracinë e “burzhoazisë” (të Jugosllavisë së paraluftës) ose komunizmin e stilit sovjetik. Ajo që ishte më e rëndësishme se ky refuzim i së kaluarës ishte dallimi të cilin komunistët jugosllavë e theksonin mes sistemit të tyre vetëqeverisës dhe sistemit sovjetik. Komunistët jugosllavë ishin të bindur, sikur që ishin edhe popujt në shumë pjesë të botës, se nuk mund të ketë kthim parapa nga socializmi në sistemet e mëparshme socio-ekonomike - drejtimi i historisë ishte përpara dhe socialistët ishin forca porgresive që i takonin drejtimit historik botëror.



Jugosllavia socialiste e ka trajtuar çështjen e minoriteteve në një mënyrë origjinale, por ajo kurrë nuk ia doli ta largonte nacionalizmin nga politika

Befasia me kolapsin sovjetik

Por, kishte lloje të ndryshme të socializmit. Jugosllavët e shihnin vetëqeverisjen e punëtorëve si shumë superiore ndaj spocializmit shtetëror që ndërli dhej me Stalinin dhe trashëgimtarët e tij konservativë. Meqë tensionet etnike dhe nacionale që ekzistonin nën sipërfaqe të shoqërisë jugosllave i konsideronin si mbeuturina të së kaluarës tashmë të diskredituar ndaj së cilës përkrahësit e tyre tepër shpesh ishin të hapur, ata nuk patën guxim që t'i japin nivelin e duhur të rëndësisë këtyre tensioneve të cilin zhvillimet e mëvonshme do të dëshmonin se e kanë merituar. Në vend të kësaj, teoricienët komunistë jugosllavë kanë tejtheksuar kër-

cënimin nga centralizmi burokratik, të cilin ata e ndërlihdnin me sovjetikët.

Kur sistemi sovjetik u shkatërrua, rrjedhimisht edhe vështrimi i tyre ndaj socializmit si një forcë progresive edhe vendimi i tyre që të definojnë veten të dalluar nga Bashkimi Sovjetik e humbi justifikimin. Komunistët e Jugosllavisë mbetën pa simbol të legjitimitetit, ndërsa elita jugosllave ishte tërësisht e papërgatitur dhe e befasar me kolapsin e sistemit sovjetik.

(Nesër: Çka ndodhi kur ra komunizmi? A mund të ekzistojë ideja e kombit pa minoritete? Cilat ishin tri çështjet më të vështira që u shfaqën gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë?)

Fejton: “Al Capone: kumbara i nëntokës” (6)

Të shtënat në dyqanin e luleve

Në dukje të parë Dion O'Banion dukej njeri i dashur që nuk përton ta përqafojë secilin që e sheh. Mirëpo, në shikim të dytë të mërdhinte me vështrimin e ftohtë të syve të tij të kaltër. Me këtë vështrim të njëjtë ai i kishte pritur tre mysafirët hijerëndë që kishin ardhur ta vizitonin në dyqanin e tij të luleve. Pak çaste më pas, gjashtë krisma janë dëgjuar në dyqan

Al Capone ishte njëzetepesëvjeçar dhe tashmë i dridhej gati e gjithë Chicagoja. Kishte kidnapuar disa politikanë dhe e kishte vrarë me dorë të vet një kapadai që shtirej se ishte gangster, por nëpër Chicago mizën e kishin bërë buall. Atij ia kishin ngarkuar vrasjet që i kryenin të tjerët: po e zëmë Dion O'Banion. Ky ishte njëfarë dauu që merrej me biznes të luleve. Në shikim të parë dukej njeri i butë. Dukej i sjellshëm dhe i shoqërueshëm. Shumëkujt i pëlqente të rrinte në shoqërinë e tij, derisa të mos mërdhihej në ftohtësinë e syve të tij të kaltër, të zbehtë. Ai me njërën dorë ta shtrëngonte dorën dhe me tjetrën ta ngulte thikën në shpinë.

Gjithmonë i mbante tri revole me vete. Të fshehura. O'Banion e kishte vrarë një njeri në pikë të ditës në midis të rrugës pa fije arsyeje - vetëm se i ishte tekur të shtiente. Pak ditë më pas kishte hyrë në lokalin e Al Capones dhe e kishte vrarë njërin që e kishte bërë me nerva.

Dion O'Banion ishte njeri me sjellje fëmijërore, por jashtëzakonisht violente. Al Capone nuk dinte çka të bënte

me të. E kishte dhe shok. Për më tepër, O'Banion i futi llafet edhe me vëllezërit Genna, partnerë të Capones dhe të Torrios. Një ditë prej ditësh, O'Banion e kishte plaçkitur një kamion me raki të vëllezërve Genna. Puna u bë e madhe dhe u ngatërrua edhe policia. Në gjithë këtë kiamet, O'Banioni diti të eskivonte, por një tjetër e hëngër burgun: Johnny Torrio, i cili ishte kthyer tashmë nga Italia.

Al Capones i erdhi gjithçka në majë të hundës.

Vetëm pak ditë më pas, më 10 nëntor të vitit 1924, Dion O'Banon ishte në dyqanin e tij të luleve. Po u merrte erë një tufe trëndafilash, kur tre persona hijerëndë hynë në dyqan. Shitësi, një punëtor i O'Banionit, e pa sa është sahati dhe menjëherë iku në nevojtoe. Dion O'Banion, po ashtu, e kuptoi se tre hijerëndët nuk kishin ardhur për të blerë vjollca në dyqanin e tij, por kishte besim në truqet e tij. E vizatoi një buzëqeshje të gjerë në fytyrë dhe e zgjati dorën për t'u bërë muhabet mysafirëve. Mirëpo, njëri prej mysafirëve, në vend të dorës ia dha një



Dion O'Banion

grusht dhe e hodhi në dysheme. Punëtori i fshehur në nevojtoe i kishte dëgjuar gjashtë të shtëna dhe disa hapa të lehtë që po largoheshin nga dyqani. Dion O'Banon kishte mbetur i shtrirë, i mbuluar me gjak. Dy vrasësit më të rrezikshëm italianë John Scalise dhe Albert Anselmi ishin në mesin e atyre që e kishin vrarë Dionin. Besohet se i treti ka qenë Frankie Yale. Dy ditë më pas ishte mbajtur varrimi që nuk kishte ngjarë në varrim. Al Capone me shokë e kishin konsideruar atë më shumë si dasmë. Me vdekjen e

Gangsterë të tjerë të shquar Leoluca Bagarella

Leoluca Bagarella ka qenë shef i “Cosa Nostras” dhe ka lindur më 1941, qëllorani ku?! Në Corleone, fshatin sicilian që përmendet në trilogjinë “Kumbara” të Francis Ford Copolas. E ka udhëhequr gjithë mafian e Italisë. Si i ri është martuar me motrën e Salvatore Riinas, shefit të Cosa Nostras dhe kjo ka bërë që Riina ta bënte pasardhës të mafias së tij. Në botën e mafias e njohin me nofkën “Dhëndri”. Mafia ka qenë me dy rryma, rrymën violente të udhëhequr nga Bagarella dhe rrymën e moderuar. Më 1995 është arrestuar nga policia italiane dhe është dënuar me burgim të përjetshëm për vrasje të shumëfishta dhe krim të organizuar. Megjithatë, edhe prapa grilave më 2002 i ka kërcënuar zyrtarët e Qeverisë së Italisë, duke kërkuar ta lironin. Tash për tash, kërcënimet e tij kanë mbetur vetëm fjalë.

O'Banionit, Capone e kishte zgjeruar edhe më territorin e tij. Mirëpo, derisa Capone e të tjerët po kremtonin, ishte një njeri që po mbante zi për të vvarin. Hymie Weiss kishte qenë mik i ngushtë i O'Banionit dhe kishte bërë be se do të merrte hak. Al Capone dhe Johnny Torrio, që ishte liruuar me kaucion nga burgu, nuk ishin aq rehat.

(Në numrin e nesërm: Kush ishte Hymie Weiss? Kush ishte Bugzy? Si reagan ndaj kërcënimeve Torrio dhe Capone? Kush dhe si bëri atentat ndaj Torrios plak?)